



Funded by
the European Union



Konsistenca e shërbimeve, si nevojë për progres!

J.D. është dhjetë vjeç dhe ndjek seanca në Qendrën Sociale Zinxhira dy herë në javë. Ai është diagnostikuar me Çrregullim të Spektrit të Autizmit dhe paraqet vështirësi që shkojnë përtej komunikimit verbal, duke përfshirë aftësitë sociale dhe shprehjen emocionale. Megjithatë, J.D. sjell me vete një prani të ngrohtë, pozitive dhe një dëshirë të fortë për t'u lidhur me të tjerët.

Gjatë seancave, J.D. tregon interes gjithnjë në rritje për ndërveprim social. Ai përfshihet me dëshirë në aktivitete të përbashkëta, respekton rregullat e pritjes së radhës dhe reagon mirë ndaj situatave sociale të udhëzuara. Me mbështetje, ai praktikon nisjen e ndërveprimit, mbajtjen e kontaktit me sy dhe njohjen e sinjaleve sociale. Me kalimin e kohës, aftësia e tij për të qëndruar i përfshirë në shkëmbime reciproke është përmirësuar ndjeshëm, dhe ai ndihet më i sigurt në komunikimin si me të rriturit ashtu edhe me bashkëmoshatarët.

Shprehja dhe ndërgjegjësimi emocional janë gjithashtu fusha të rëndësishme të punës sonë. J.D. po mëson të identifikojë dhe emërtojë emocionet – si të tijat ashtu edhe të të tjerëve – dhe t'i diskutojë ato në një mënyrë të strukturuar dhe të sigurt. Ai reagon shumë mirë ndaj materialeve vizuale, tregimeve dhe lojërave me role, të cilat e ndihmojnë të lidhë emocionet me situata të përditshme. Si rezultat, ai po bëhet më i aftë të shprehë ndjenja si gëzimi, frustrimi apo entuziazmi përmes fjalëve dhe jo përmes sjelljeve.

Rregullimi emocional është një tjetër fushë ku vërehet progres i dukshëm. Kur detyrat bëhen më sfiduese, J.D. po arrin gjithnjë e më shumë të tolerojë frustrimin, të kërkojë ndihmë dhe të vazhdojë aktivitetin pa u tërhequr. Ai tregon fleksibilitet dhe reziliencë në rritje, gjë që mbështet si procesin e të nxënimit ashtu edhe pjesëmarrjen sociale. Këto përparime reflektojnë motivimin e tij të fortë dhe aftësinë për të përvetësuar strategjitë e përballimit të prezantuara gjatë seancave.





Funded by
the European Union



unicef
for every child

World Vision

Paralelisht me punën në Qendrën Sociale Zinxhira, J.D. merr mbështetje edhe nga një specialist i trajnuar në ABA në një qendër tjetër. Kjo ndërhyrje shtesë plotëson punën e stafit Zinxhira dhe është tregues i nevojës për ndërveprime nderinstitucionale. Konsistenca mes shërbimeve ka një ndikim pozitiv në progresin e tij të përgjithshëm.

Përmes seancave dy herë në javë, J.D. vazhdon të zhvillojë jo vetëm komunikim më të qartë, por edhe aftësi sociale më të forta, kuptim më të thellë emocional dhe vetëbesim më të madh. Rrugëtimi i tij karakterizohet nga rritje e qëndrueshme, përpjekje e sinqertë dhe një aftësi gjithnjë e më e sigurt për t'u lidhur me botën përreth.

- *Emri i përfitueses është ndryshuar për të mbrojtur privatësinë.*

Kjo histori sukesi u realizua si pjesë e projektit “Fuqizimi i Kapaciteteve të Qendrës Sociale Komunitare Zinxhira për të Ofruar Shërbime të Specializuara dhe Gjithëpërfshirëse për Komunitetet në Nevojë në Gjirokastrë”, i zbatuar nga Bashkia Gjirokastrë në partneritet me IRCA, si pjesë e programit “BE për Kujdesin Social”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNICEF Shqipëri dhe World Vision Albania, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale.



Consistency of Services: A Need for Progress

J.D. is ten years old and attends sessions at the Zinxhira Social Center twice a week. He has been diagnosed with Autism Spectrum Disorder and presents challenges that go beyond verbal communication, including social skills and emotional expression. Nevertheless, J.D. brings with him a warm, positive presence and a strong desire to connect with others.

During sessions, J.D. demonstrates a steadily growing interest in social interaction. He eagerly participates in shared activities, respects turn-taking rules, and responds well to guided social situations. With support, he practices initiating interactions, maintaining eye contact, and recognizing social cues. Over time, his ability to stay engaged in reciprocal exchanges has improved significantly, and he feels more confident communicating with both adults and peers.

Emotional expression and awareness are also key areas of focus. J.D. is learning to identify and label emotions—both his own and those of others—and to discuss them in a structured and safe manner. He responds very well to visual materials, stories, and role-playing games, which help him link emotions to everyday situations. As a result, he is becoming increasingly able to express feelings such as joy, frustration, or excitement through words rather than behaviors.

Emotional regulation is another area where notable progress is observed. As tasks become more challenging, J.D. is increasingly able to tolerate frustration, ask for help, and continue activities without withdrawing. He demonstrates growing flexibility and resilience, which support both his learning process and social participation. These advancements reflect his strong motivation and his ability to internalize coping strategies introduced during sessions.

In parallel with the work at the Zinxhira Social Center, J.D. also receives support from a trained ABA specialist at another center. This additional intervention complements the efforts of the



Funded by
the European Union



Zinxhira staff and highlights the importance of inter-institutional coordination. Consistency across services has a positive impact on his overall progress.

Through twice-weekly sessions, J.D. continues to develop not only clearer communication but also stronger social skills, deeper emotional understanding, and greater self-confidence. His journey is characterized by steady growth, sincere effort, and an increasingly confident ability to connect with the world around him.

The beneficiary's name has been changed to protect privacy.

This success story was realized as part of the project **“Strengthening the Capacities of the Zinxhira Community Social Center to Provide Specialized and Comprehensive Services to Communities in Need in Gjirokaštër”**, implemented by the Municipality of Gjirokaštër in partnership with **IRCA**, as part of the **“EU for Social Care”** program, funded by the European Union and implemented by **UNICEF Albania** and **World Vision Albania**, in cooperation with the Ministry of Health and Social Protection.

